

BULETIN JAVOR

27-31 MAJ 2023




Shprehja

"Vendimi që marrim për sigurinë sot do të përcaktojë llojin e shoqërisë në të cilën jetojmë nesër."

e javës

Përmbajtja:

- Përditësim i rëndësishëm sigurie nga Microsoft
- Aplikacionet Android me spyware të instaluar 421 milionë herë nga Google Play
- Toyota- data breach
- Google Chrome-Patching Alert



Përditësim i rëndësishëm sigurie nga Microsoft

Apple kohët e fundit ka adresuar një vulnerabilitet të identifikuar si [CVE-2023-32369](#) që lejon sulmuesit të anashkalojnë Mbrotjtjen e Integritetit të Sistemit (SIP) për të instaluar malware dhe për të hyrë në të dhënat private të viktimës duke anashkaluar kontrollin e sigurisë të Transparencës, Pëlqimit dhe Kontrollit (TCC).

Ky vulnerabilitet mund t'i lejojë sulmuesit të prekin integritetin e sistemit përmes ekzekutimit arbitrar të kodit të kernelit dhe potencialisht të instalojnë rootkits për të fshehur proceset dhe skedarët keqdashës nga softueri i sigurisë.

Apple ka korrigjuar vulnerabilitetin në përditësimet e sigurisë për macOS Ventura 13.4, macOS Monterey 12.6.6 dhe macOS Big Sur 11.7.7

[Link: Lexo më shumë](#)



Toyota gjen më shumë serverë të keqkonfiguruar që rrjedhin informacione për klientët

Toyota Motor Corporation ka zbuluar së fundmi dy shërbime shtesë cloud të keqkonfiguruar të cilat zbuluan informacione personale të pronarëve të makinave për më shumë se shtatë vjet. Baza e të dhënave, e cila duhet të ishte e aksesueshme vetëm për tregtarët dhe ofruesit e shërbimeve, u ekspozua publikisht, duke zbuluar të dhëna të klientit si: adresa, emri, numri i telefonit, adresa e emailit, numri i identifikimit të automjetit (VIN)

Toyota ka implementuar një sistem që monitoron rregullisht konfigurimet e cloud dhe cilësimet e bazës së të dhënave në të gjitha mjediset e saj për të parandaluar këto lloj incidentesh në të ardhmen.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT

New in

Chrome

114

Google Chrome-përditësim sigurie

Google ka publikuar versionin më të ri të shfletuesit Chrome 114, i cili përfshin 18 përditësime sigurie, si edhe *patching* për 13 vulnerabilitete.

Nga vulnerabilitetet e raportuara, tetë prej tyre vlerësohen me rrezikshmëri të lartë dhe gjashtë prej tyre janë vulnerabilitete të sigurisë së kujtesës. Për të zbutur rrezikun Google ka publikuar versionin më të fundit 114.0.5735.90 për Linux dhe macOS dhe si versioni 114.0.5735.90/91 për Windows.

AKCESK rekomandon të gjithë përdoruesit e Google Chrome të instalojnë përditësimet e fundit.

[Link: Lexo më shumë](#)



Aplikacionet Android me spyware të instaluar 421 milionë herë nga Google Play

Një malware i ri Android i zbuluar në shumë aplikacione në Google Play, është shkarkuar kolektivisht mbi 400 milionë herë.

Studiuesit e sigurisë e gjurmuan dhe e identifikuan atë si 'SpinOK', duke paralajmëruar se ai mund të vjedhë të dhënat private të ruajtura në pajisjet e përdoruesve dhe t'i dërgojë ato në një server të largët.

Për të gjithë përdoruesit e Android rekomandohet që të ç'instaloni menjëherë cdo aplikacion të dyshimtë dhe të skanoni pajisjen tuaj me një mjet antivirus për t'u siguruar që të gjitha mbetjet e spiunazhit janë hequr.

[Link: Lexo më shumë](#)